



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____ Datë ____ .09.2026

“PËR MIRATIMIN E BASHKËFINANCIMIT TË PROJEKTIT VILA E RILINDJES”

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar dhe në vijim të të aplikimit të bashkisë Kolonjë në Thirrjen për Aplikime në kuadër të Skemës “Mekanismi i Nxitjes së Kapaciteteve Bashkiakë për Zbatimin e Projekteve, Faza II”, si një nga ndërhyrjet e programuara nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe të buxhetuar në Programin e tij Operacional për periudhën afatmesme 2026-2028, Programi “Infrastruktura Vendore Rajonale” kryetari i bashkisë në mbledhjen e datës 21.09.2026:

PROPOZOI:

1. Miratimin e pjesëmarrjes së Bashkisë Kolonjë në bashkëfinancimin e projektit “Vila e Rilindjes”, me vlerë totale të projektit **26,400,000.00 lekë**.
2. Miratimin e bashkëfinancimit të Bashkisë Kolonjë në vlerën **2,400,000.00 lekë**, që përfaqëson **10%** të vlerës totale të projektit.
3. Për zbatimin e këtij projekt- vendimi ngarkohen Drejtoria e Financës, Ekonomisë dhe Buxhetit dhe Drejtoria e Zhvillimit, Planifikimit të Territorit dhe Mjedisit të Bashkisë Kolonjë .
4. Ky projekt- vendim hyn në fuqi ne mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

KRYETAR
ERION ISAI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË

Nr 5827 Prot.

RELACION

Enkelo: 16.9.2026

PËR

PROJEKT-VENDIM

Nr. ___ Datë __.09.2026

“PËR MIRATIMIN E BASHKËFINANCIMIT TË PROJEKTIT VILA E RILINDJES”.

Të nderuar!

Në vijim të aplikimit të bashkisë Kolonjë në Thirrjen për Aplikime në kuadër të Skemës “Mekanizmi i Nxitjes së Kapaciteteve Bashkiake për Zbatimin e Projekteve, Faza II”, si një nga ndërhyrjet e programuara nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe të buxhetuar në Programin e tij Operacional për periudhën afatmesme 2026-2028, Programi “Infrastruktura Vendore Rajonale”, ju bëjmë me dije se aplikimi me titull: “*Vila e Rilindjes (Renaissance Villa)*”, është përzgjedhur fitues për fazën e parë të aplikimit.

Bazuar në pikën 3.3 të Udhëzuesit të Thirrjes, Në vijim të miratimit në platformë për Fazën I, aplikantët e përzgjedhur do të dorëzojnë elektronikisht paketën e plotë të dokumentacionit, në të cilën përfshihet edhe Kopje e vendimit të Këshillit Bashkiak, i cili miraton vlerën e bashkëfinancimit prej **10% (2,400,000.00 lekë)** të investimit total **(26,400,000.00 lekë)**.

Bashkangjitur :

1.Përmbledhje e projektit Vila e Rilindjes.

Konceptoi: Specialist Xh.Kalemaj

Kontrolloi: Drejtori D.P.ZH.T.M Ing. **Muharem**

Konfirmoi: Drejtori D.C.J.P.P O.Lifo **Tartari**

Digitally signed by Muharem Tartari
Date: 2026.09.17 15:25:35 +02'00'



THIRRJE PËR APLIKIME PËR SKEMËN

“MBËSHTETJE PËR FUQIZIMIN E KAPACITETEVE MENAXHUESE TË BASHKIVE NËPËRMJET APLIKIMIT TË SKEMAVE TË GRANTEVE, FAZA II”

Data e aplikimit	10/07/2026
------------------	------------

1. PËRMBLEDHJE E PROJEKTIT

Titulli i Projektit	Vila e Rilindjes (Renaissance Villa)
Aplikanti(Emri i NJVV)	KOLONJË
Vendodhja e projektit	Ersekë, Kolonjë
Kohëzgjatja e Projektit	12
Objektivat e projektit	- Krijimi i një hapësirë turistike tematike, e konceptuar si një vilë tradicionale kolonjare, ku vizitorët të përjetojnë atmosferën historike përmes dizajnit autentik dhe teknologjisë moderne. - Zhvillimi i një platformë e bazuar në Inteligjencën Artificiale, e cila mundëson bashkëbisedim virtual me figurat e Rilindjes së Kolonjës, duke ofruar përgjigje në gjuhën amtare të çdo vizitori. - Rritja e atraktivitetit turistik të Kolonjës, duke krijuar një produkt unik kulturor që nuk ofrohet aktualisht në Shqipëri dhe që mund të tërheqë turistë vendas e të huaj gjatë gjithë vitit. - Mbështetja e ekonomisë lokale, duke krijuar mundësi të reja punësimi, duke rritur kohëzgjatjen e qëndrimit të turistëve dhe duke promovuar produktet tradicionale, gastronominë dhe artizanatin e zonës. - Krijimi i eksperiencave të personalizuar për vizitorët, ku çdo turist mund të zgjedhë figurën historike me të cilën dëshiron të bashkëbisedojë, temat e diskutimit dhe gjuhën e komunikimit. - Pozicionimi i Kolonjës si një destinacion lider i turizmit kulturor inovativ, duke integruar trashëgiminë, teknologjinë dhe gastronominë në një eksperiencë të vetme.
Nr. i banorëve përfitues	17,861

Nr. i bizneseve përfituese	292
Nr. i turistëve/vizitorëve përfitues	30,000
Rezultatet e pritshme të Projektit	"Vila e Rilindjes" do të funksionojë si një destinacion inovativ i turizmit kulturor, ku trashëgimia historike e Kolonjës ndërthuret me inteligjencën artificiale dhe teknologjitë digjitale për të ofruar një eksperiencë unike dhe shumëgjuhëshe për vizitorët. Projekti pritet të rrisë numrin e turistëve vendas dhe të huaj, të promovojë figurat e shquara të Rilindjes së Kolonjës dhe të forcojë identitetin kulturor të Kolonjës. Njëkohësisht, ai do të kontribuojë në zhvillimin ekonomik lokal përmes rritjes së aktivitetit turistik, promovimit të gastronomisë dhe produkteve tradicionale, si dhe krijimit të mundësive të reja për punësim. "Vila e Rilindjes" synon të shërbejë gjithashtu si një model i qëndrueshëm dhe i riprodhueshëm i turizmit kulturor inovativ, duke e pozicionuar Kolonjën si një destinacion të veçantë në hartën turistike të Shqipërisë.

2. KONTAKTET

Informacioni për të kontaktuar aplikantin në lidhje me këtë projekt:

Adresa postare e Aplikimit:	Kodi Postar 7401 Erseke, Kolonje
Adresa email e Aplikantit:	xh.kalemaj@hotmail.com
Personi i kontaktit për këtë Projekt:	Xhensila Kalemaj
Nr Telefoni:	0675532636

3. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

● Përshkruani kontekstin (shpjegoni nevojën) e projektit

Rajoni i Kolonjës është një nga trevat me kontributin më të madh në historinë, arsimin dhe kulturën shqiptare. Kjo zonë ka nxjerrë personalitete të shquara të Rilindjes Kombëtare, të cilët kanë luajtur një rol vendimtar në përhapjen e arsimit shqip, zhvillimin e kulturës kombëtare dhe përpjekjet për pavarësinë e vendit. Figura si Petro Nini Luarasi, Pandeli Sotiri, Nuçi Naçi, Sotir Peçi, Jani Vreto, Thanas Sina, Motrat Qirjazi përfaqësojnë vlera të jashtëzakonshme historike dhe kulturore, duke lënë një trashëgimi që vazhdon të jetë një burim frymëzimi për brezat e sotëm.

Megjithatë, kjo trashëgimi e pasur nuk është ende e promovuar dhe interpretuar në mënyrë bashkëkohore për vizitorët vendas dhe të huaj. Shumë turistë që vizitojnë Shqipërinë nuk kanë mundësi të njihen me historinë dhe kontributin e këtyre figurave në një mënyrë tërheqëse, ndërvepruese dhe të aksesueshme në gjuhën e tyre.

Në të njëjtën kohë, tendencat globale të turizmit tregojnë një rritje të kërkesës për përvoja autentike, ndërvepruese dhe të personalizuar. Vizitorët nuk mjaftohen më vetëm me vizitën e muzeve apo monumenteve tradicionale, por kërkojnë të përjetojnë historinë përmes teknologjisë, inteligjencës artificiale dhe eksperiencave imersive. Kjo qasje jo vetëm e bën historinë më të kuptueshme dhe më tërheqëse, por krijon edhe një lidhje emocionale mes vizitorit dhe trashëgimisë kulturore.

Në këtë kontekst, projekti "Vila e Rilindjes" synon të krijojë një qendër inovative të turizmit kulturor, ku vizitorët do të kenë mundësinë të shijojnë gastronominë tradicionale të Kolonjës dhe, njëkohësisht, të zhvillojnë bashkëbisedime virtuale me figurat më të njohura të Rilindjes së kësaj treve. Përmes inteligjencës artificiale dhe një platforme shumëgjuhëshe, turistët do të mund të komunikojnë në gjuhën e tyre me personalitete si Petro Nini Luarasi, Pandeli Sotiri, Nuçi Naçi, Sotir Peçi, Jani Vreto dhe Thanas Sina, duke i pyetur për jetën, veprën, historinë e Kolonjës, traditat, arsimin, kulturën dhe ngjarjet më të rëndësishme të kohës së tyre. Përgjigjet do të bazohen në burime historike të verifikuara, duke krijuar një përvojë edukative, autentike dhe gjithëpërfshirëse.

Projekti adreson njëkohësisht disa nevoja strategjike: ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, diversifikimin e ofertës turistike të Kolonjës, rritjen e atraktivitetit të destinacionit për turistët ndërkombëtarë, përdorimin e teknologjive inovative në interpretimin e historisë dhe zhvillimin ekonomik lokal përmes rritjes së fluksit turistik. Gjithashtu, ai krijon mundësi të reja për promovimin e produkteve tradicionale, gastronomisë lokale dhe artizanatit, duke gjeneruar përfitime për komunitetin dhe bizneset vendase.

"Vila e Rilindjes" synon të shndërrohet në një model të ri të turizmit kulturor në Shqipëri, duke dëshmuar se trashëgimia historike mund të ruhet dhe promovohet në mënyrë inovative përmes inteligjencës artificiale, teknologjive digjitale dhe eksperiencave interaktive. Projekti do të kontribuojë në pozicionimin e Kolonjës si një destinacion unik të turizmit kulturor dhe edukativ, duke e bërë historinë shqiptare të gjallë dhe të aksesueshme për vizitorë nga e gjithë bota.

● **Shpjegoni objektivat e projektit të paraqitura në Seksionin 1 "Informacion i përgjithshëm"**

Krijimi i një hapësirë turistike tematike, e konceptuar si një vilë tradicionale kolonjare, ku vizitorët të përjetojnë atmosferën historike përmes dizajnit autentik dhe teknologjisë moderne.

Ndërtimi i një vile të frymëzuar nga arkitektura tradicionale kolonjare, e pajisur me teknologji moderne, ku vizitorët të përjetojnë historinë, kulturën dhe mikpritjen e zonës në një ambient autentik.

Zhvillimi i një platformë e bazuar në Inteligjencën Artificiale, e cila mundëson bashkëbisedim virtual me figurat e Rilindjes së Kolonjës, duke ofruar përgjigje në gjuhën amtare të çdo vizitori.

Krijimi i një sistemi inteligjent që u mundëson vizitorëve të bashkëbisedojnë virtualisht me figurat e Rilindjes së Kolonjës në gjuhën e tyre, duke ofruar informacion historik të saktë dhe një eksperiencë ndërvepruese.

Rritja e atraktivitetit turistik të Kolonjës, duke krijuar një produkt unik kulturor që nuk ofrohet aktualisht në Shqipëri dhe që mund të tërheqë turistë vendas e të huaj gjatë gjithë vitit.

Krijimi i një produkti turistik inovativ që pasuron ofertën kulturore të rajonit, tërheq vizitorë gjatë gjithë vitit dhe e bën Kolonjën një destinacion më konkurrues në tregun turistik

Mbështetja e ekonomisë lokale, duke krijuar mundësi të reja punësimi, duke rritur kohëzgjatjen e qëndrimit të turistëve dhe duke promovuar produktet tradicionale, gastronominë dhe artizanatin e zonës.

Nxitja e zhvillimit ekonomik përmes krijimit të vendeve të reja të punës, rritjes së konsumit të produkteve dhe shërbimeve lokale, si dhe promovimit të gastronomisë dhe artizanatit tradicional.

Krijimi i eksperiencave të personalizuar për vizitorët, ku çdo turist mund të zgjedhë figurën historike me të cilën dëshiron të bashkëbisedojë, temat e diskutimit dhe gjuhën e komunikimit.

Ofrimi i një përvoje unike dhe të personalizuar, ku çdo vizitor mund të zgjedhë figurën historike, temat e interesit dhe gjuhën e komunikimit sipas preferencave të tij.

Pozicionimi i Kolonjës si një destinacion lider i turizmit kulturor inovativ, duke integruar trashëgiminë, teknologjinë dhe gastronominë në një eksperiencë të vetme.

Promovimi i Kolonjës si një destinacion modern që ndërthur trashëgiminë kulturore, teknologjinë dhe gastronominë, duke krijuar një model të ri dhe të qëndrueshëm të turizmit kulturor në Shqipëri

- **Përshkruani grupet kryesore të interesit, interesin e tyre te projekti dhe konsultimet që mund të keni kryer me ta (nëse ka) si dhe se si në sajë të projektit do të përmirësohet gjendja e grupeve të synuara dhe të përfituesve përfundimtarë**

Projekti "Vila e Rilindjes" synon të përfshijë dhe të sjellë përfitime për disa grupe kryesore të interesit, të cilët do të kenë rol aktiv në zbatimin dhe zhvillimin e tij.

Përfituesit kryesorë janë rreth 30000 turistë vendas dhe të huaj në vit, të cilët do të kenë mundësinë të përjetojnë një eksperiencë unike që kombinon historinë, kulturën, gastronominë tradicionale dhe inteligjencën artificiale. Përmes bashkëbisedimit virtual me figurat e Rilindjes së Kolonjës në gjuhën e tyre, ata do të kenë akses në një formë moderne, interaktive dhe edukative të interpretimit të trashëgimisë kulturore.

Një grup tjetër i rëndësishëm janë komuniteti lokal, rreth 292 biznese dhe prodhuesit vendas, të cilët do të përfitojnë nga rritja e fluksit turistik. Rritja e numrit të vizitorëve pritët të ndikojë pozitivisht në sektorët e akomodimit, gastronomisë, artizanatit dhe produkteve tradicionale, duke krijuar mundësi të reja punësimi dhe duke gjeneruar të ardhura shtesë për ekonominë lokale.

Përfitues janë gjithashtu institucionet kulturore, arsimore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat do të disponojnë një model inovativ për promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Projekti do të kontribuojë në rritjen e vizibilitetit të Kolonjës si destinacion turistik dhe do të mbështesë strategjitë lokale për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm.

Një grup me rëndësi janë edhe nxënësit, studentët, studiuesit dhe të rinjtë, të cilët do të kenë mundësi të mësojnë mbi historinë dhe figurat e Rilindjes Kombëtare përmes një metode moderne, interaktive dhe shumëgjuhëshe, duke rritur interesin për kulturën dhe identitetin kombëtar.

Në tërësi, projekti përmirëson situatën e përfituesve duke krijuar një produkt të ri të turizmit kulturor që rrit atraktivitetin e Kolonjës, promovon trashëgiminë historike, gjeneron zhvillim ekonomik lokal dhe ofron një përvojë inovative që lidh traditën me teknologjinë moderne.

- **Përshkruani shkurtimisht logjikën e ndërhyrjes që përbën bazën e Projektit, ku të tregoni produktet, rezultatet, ndikimin e pritshëm si dhe evidentimin e rezeqeve kryesore dhe supozimeve për arritjen e tyre**

Projekti "Vila e Rilindjes" bazohet në ndërthurjen e trashëgimisë kulturore me teknologjinë moderne për të krijuar një produkt inovativ të turizmit kulturor. Ndërhyrja parashikon krijimin e një hapësire turistike të konceptuar si një vilë tradicionale kolonjare, të pajisur me një

platformë të bazuar në inteligjencën artificiale, e cila do t'u mundësojë vizitorëve të bashkëbisedojnë virtualisht me figurat e shquara të Rilindjes së Kolonjës në gjuhën e tyre. Projekti do të integrojë gjithashtu gastronominë tradicionale, elementët e trashëgimisë kulturore dhe përmbajtje historike të verifikuara për të krijuar një eksperiencë autentike dhe ndërvepruese. Produktet e projektit do të jenë krijimi i "Vilës së Rilindjes", zhvillimi i platformës shumëgjuhëshe me inteligjencë artificiale, krijimi i përmbajtjeve historike dhe edukative, pajisja e ambientit me teknologjitë e nevojshme dhe realizimi i aktiviteteve promovuese për prezantimin e destinacionit.

Rezultatet pritet të jenë rritja e atraktivitetit turistik të Kolonjës, rritja e numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj, promovimi i figurave të Rilindjes Kombëtare, përmirësimi i aksesit në trashëgiminë kulturore përmes teknologjisë dhe forcimi i ekonomisë lokale nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve turistike. Ndikimi afatgjatë do të konsistojë në pozicionimin e Kolonjës si një destinacion lider i turizmit kulturor inovativ në Shqipëri, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore përmes transformimit digjital, krijimin e një modeli të qëndrueshëm të turizmit kulturor që mund të replikohet edhe në rajone të tjera, si dhe rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të komunitetit lokal.

Zbatimi i projektit mund të përballet me rreziqe si vonesa në zhvillimin dhe integrimin e teknologjisë së inteligjencës artificiale, vështirësi në sigurimin e përmbajtjeve historike të standardizuara, nivel më i ulët se pritshmëritë të numrit të vizitorëve në fazat e para, ose sfida në mirëmbajtjen e teknologjive të përdorura. Këto rreziqe do të adresohen përmes planifikimit të detajuar të aktiviteteve, bashkëpunimit me ekspertë të historisë dhe teknologjisë, testimit të platformës përpara lançimit dhe një strategjie të mirëfilltë marketingu e promovimi.

Projekti mbështetet në disa supozime kryesore: ekzistenca e interesit në rritje për turizmin kulturor dhe eksperiencat digjitale, bashkëpunimi i institucioneve lokale dhe aktorëve të sektorit të turizmit, disponueshmëria e teknologjive të nevojshme dhe angazhimi i komunitetit lokal në promovimin dhe zhvillimin e produktit turistik. Përmeshja e këtyre supozimeve do të krijojë kushtet për arritjen e objektivave dhe garantimin e qëndrueshmërisë së projektit edhe pas përfundimit të financimit.

● **Paraqisni çdo faktor specifik dhe/apo rreziqe/supozime që mund të impaktojë afatin kohor të projektit**

Zbatimi i projektit mund të ndikohet nga disa faktorë të jashtëm dhe të brendshëm që mund të shkaktojnë vonesa në realizimin e aktiviteteve. Ndër rreziqet kryesore janë vonesat në procedurat e prokurimit dhe furnizimit me pajisje teknologjike, zhvillimi dhe testimi i platformës së bazuar në inteligjencën artificiale, si dhe procesi i krijimit dhe verifikimit të

përmbajtjeve historike që do të përdoren në bashkëbisedimet virtuale. Gjithashtu, mund të ketë vonesa në rikonstruksionin ose përshtatjen e ambientit të vilës për shkak të procedurave administrative, kushteve atmosferike ose mungesës së materialeve. Rreziqe të tjera lidhen me disponueshmërinë e ekspertëve të teknologjisë dhe historianëve, koordinimin ndërmjet partnerëve të projektit, si dhe me ritmin e adoptimit të teknologjisë nga vizitorët gjatë fazës fillestare të funksionimit.

4. RËNDËSIA E PROJEKTIT

4.1. Lidhja me nevojat specifike dhe vështirësitë e rajonit të synuar (përfshirë këtu edhe sinergjinë me nisma të tjera zhvillimi dhe shmangien e duplikimeve/mbivendosjeve)

Clearly explain the specific situation before the project in the targeted region and/or sectors (including quantitative analysis where possible).

● **Jepni një analizë të detajuar të problemeve rajonale/lokale/kombëtare që do të trajtohen nga projekti.**

Rrethi i Kolonjës përfaqëson një nga zonat me vlera të jashtëzakonshme historike, kulturore dhe natyrore në Shqipëri. Kolonja ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në historinë e Rilindjes Kombëtare, duke qenë vendlindja e shumë personaliteteve të shquara që kanë ndikuar në arsimin, kulturën dhe pavarësinë e vendit. Megjithatë, pavarësisht këtij potenciali të madh, zona vazhdon të përballlet me sfida të konsiderueshme në zhvillimin ekonomik dhe turistik.

Një nga problemet kryesore në nivel lokal është shfrytëzimi i kufizuar i trashëgimisë kulturore si një burim zhvillimi ekonomik. Shumë objekte, histori dhe figura të rëndësishme historike njihen vetëm nga komuniteti vendas dhe nuk janë interpretuar në mënyrë moderne për vizitorët shqiptarë dhe të huaj. Mungojnë produktet turistike inovative që ndërthurin historinë, teknologjinë dhe eksperiencën interaktive, duke bërë që turistët të qëndrojnë për periudha të shkurtra dhe të kenë pak mundësi për të njohur identitetin kulturor të zonës. Një tjetër problem është sezonaliteti i turizmit dhe mungesa e aktiviteteve gjatë gjithë vitit. Vizitat në Kolonjë përqendrohen kryesisht në periudha të caktuara, ndërsa mungojnë atraksione që mund të funksionojnë në çdo stinë dhe të tërheqin kategori të ndryshme vizitorësh, përfshirë turistët ndërkombëtarë, familjet, grupet shkollore dhe studiuesit. Në nivel rajonal, qarku i Korçës ka potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e turizmit kulturor, por oferta turistike mbetet e përqendruar kryesisht në disa destinacione të njohura, ndërsa zona si Kolonja përfitojnë në një masë shumë më të vogël nga flukset turistike. Kjo krijon pabarazi në

zhvillimin ekonomik të territorit dhe kufizon mundësitë për krijimin e vendeve të reja të punës dhe zhvillimin e sipërmarrjeve lokale.

Një sfidë tjetër është mungesa e përdorimit të teknologjive dixhitale në interpretimin e trashëgimisë kulturore. Sot turistët kërkojnë përvoja gjithëpërfshirëse, interaktive dhe të personalizuar, ndërsa shumica e muzeve apo pikave të interesit në zonë ofrojnë forma tradicionale të prezantimit. Për pasojë, potenciali i inteligjencës artificiale, realitetit virtual dhe përkthimit shumëgjuhësh mbetet pothuajse i pashfrytëzuar.

Përmes këtij projekti do të rritet atraktiviteti turistik i Kolonjës, do të zgjatet koha e qëndrimit të vizitorëve, do të krijohen mundësi të reja punësimi dhe të ardhurash për komunitetin lokal, si dhe do të forcohet ruajtja dhe promovimi i identitetit kulturor shqiptar përmes përdorimit të teknologjive bashkëkohore. Projekti kontribuon gjithashtu në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, në transformimin dixhital të sektorit kulturor dhe në shpërndarjen më të balancuar të përfitimeve ekonomike në zonat rurale të vendit.

● **Referojuni çdo plani të rëndësishëm të ndërmarrë në nivel kombëtar, rajonal dhe/ose vendor që lidhet me projektin dhe përshkruani si do të ndërlidhet projekti me këto plane.**

Në nivel lokal, projekti është në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) të Bashkisë Kolonjë (Vendimi Nr 2, datë 17.05.2019) i vlefshëm deri në vitin 2034 dhe prioritetet e zhvillimit vendor për promovimin e trashëgimisë kulturore, zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, mbështetjen e sipërmarrjes lokale dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Projekti "Vila e Rilindjes" është gjithashtu në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Turizmit, (Vendimi Nr 466 datë 31.07.2025 PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT 2025–2030 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT" e cila promovon zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, zgjerimin e ofertës turistike, promovimin e trashëgimisë kulturore dhe krijimin e produkteve turistike me vlerë të shtuar.

Projekti është gjithashtu në përputhje me politikat kombëtare për transformimin dixhital, duke integruar inteligjencën artificiale, komunikimin shumëgjuhësh dhe teknologjitë interaktive në sektorin e turizmit dhe kulturës. Kjo mbështet modernizimin e shërbimeve turistike dhe rrit konkurrueshmërinë e destinacioneve shqiptare në tregun ndërkombëtar.

● **Nëse projekti është vazhdim i një projekti të mëparshëm apo që plotëson një projekt në vazhdim, tregoni qartë se si projekti i propozuar do të kontribuojë/ plotësojë aktivitetet/rezultatet e projektit të mëparshëm apo në vazhdim; referojuni përfundimeve kryesore dhe rekomandimeve të çdo vlerësimi të kryer.**

Projekti është i ri dhe inovativ, pra nuk është vazhdim i një projekti të mëparshëm ose

programi në vijim.

- **Aty ku Projekti është pjesë e një programi më të madh, shpjegoni qartësisht si përputhet apo si bashkërendohet projekti me këtë program apo me projekte të tjera të planifikuara.**

Projekti "Vila e Rilindjes" është konceptuar si një investim që plotëson dhe fuqizon iniciativat ekzistuese për zhvillimin e turizmit, kulturës dhe ekonomisë lokale në Bashkinë Kolonjë. Edhe pse zbatohet si një projekt i pavarur, ai është plotësisht në përputhje me programet dhe investimet që synojnë promovimin e trashëgimisë kulturore, zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe dixhitalizimin e shërbimeve turistike. Koordinimi do të realizohet në bashkëpunim me Bashkinë Kolonjë, institucionet kulturore, operatorët turistikë, bizneset lokale, fermerët, artizanët, shkollat dhe organizatat e shoqërisë civile. Ky bashkëpunim do të mundësojë promovimin e përbashkët të destinacionit, organizimin e aktiviteteve kulturore dhe edukative, si dhe krijimin e paketave turistike të integruara që zgjasin kohën e qëndrimit të vizitorëve dhe rrisin përfitimet ekonomike për komunitetin.

4.2. Elementë të veçantë që i shtojnë vlerë projektit

Evidentoni çdo element të veçantë që i shton vlerë projektit (p.sh. inovacion, aspekt ekologjik, zgjidhje smart, praktika të mira, etj.)

Vlera e shtuar e projektit "Vila e Rilindjes" qëndron në krijimin e një eksperience unike dhe gjithëpërfshirëse për vizitorët, e cila nuk ofrohet aktualisht në rajon.

Përdorimi i inteligjencës artificiale (AI) për të rikrijuar në mënyrë virtuale figurat e Rilindjes Kombëtare të lidhura me Kolonjën, duke u mundësuar vizitorëve të zhvillojnë biseda interaktive, të bëjnë pyetje dhe të marrin përgjigje të personalizuar në kohë reale (rast konkret Motrat Qirjazi i mësojnë një turisti si gatuhet një lakror dhe ai e bën konkretisht). Komunikimi shumëgjuhësh, që u lejon turistëve të komunikojnë në gjuhën e tyre amtare pa pasur nevojë për përkthyes apo guida të specializuara, duke e bërë përvojën të aksesueshme për vizitorë nga e gjithë bota.

Ndërthurja e kulturës me gastronominë, ku vizitorët shijojnë gatimet tradicionale të Kolonjës ndërsa përjetojnë historinë dhe dialogojnë virtualisht me figurat historike.

Interpretim modern i trashëgimisë kulturore, duke kaluar nga format tradicionale të ekspozimit në një model interaktiv dhe edukativ që rrit interesin e brezave të rinj dhe të turistëve ndërkombëtarë.

Kontribut në transformimin dixhital të turizmit, përmes integritit të inteligjencës artificiale dhe teknologjive të komunikimit në një shërbim kulturor dhe turistik, në përputhje me

tendencat bashkëkohore të turizmit inteligjent (Smart Tourism).

4.3. Përfitimet dhe ndikimi që mund të sjellë projekti

Jepni informacion mbi potencialin e pritshëm të projektit për zhvillim të mëtejshëm.

Në tërësi, "Vila e Rilindjes" ka potencial të zhvillohet nga një investim lokal në një model referues për turizmin kulturor dhe dixhital në Shqipëri, duke krijuar vlerë të qëndrueshme ekonomike, sociale dhe kulturore dhe duke kontribuar në promovimin ndërkombëtar të trashëgimisë shqiptare. Nga pikëpamja financiare, projekti ka potencial për të gjeneruar të ardhura të qëndrueshme përmes shërbimeve të akomodimit, restorantit, biletave të eksperiencës interaktive, organizimit të aktiviteteve kulturore, suvenireve, produkteve lokale dhe partneriteteve me operatorë turistikë. Këto burime të diversifikuara të ardhurash do të mbështesin mirëmbajtjen, përmirësimin dhe zgjerimin e vazhdueshëm të projektit edhe pas përfundimit të financimit.

5. PLANI I AKTIVITETEVE

Emërtimi i Aktivitetit	Përshkrim i shkurtër i Aktivitetit	Objekti i kontratës	Buxheti i Kontratës në Lekë:	Burimi i Financimit	Lloji i procedurës	Koha e parashikuar për realizimin e procedurës së prokurimit (në muaj):	Data e parashikuar e fillimit të kontratës	Data e parashikuar e përfundimit të kontratës

Emërtimi i Aktivitetit	Përshkrim i shkurtër i Aktivitetit	Objekti i kontratës	Buxheti i Kontratës në Lekë:	Burimi i Financimit	Lloji i procedurës	Koha e parashikuar për realizimin e procedurës së prokurimit (në muaj):	Data e parashikuar e fillimit të kontratës	Data e parashikuar e përfundimit të kontratës
Menaxhimi, koordinimi dhe monitorimi i projektit	Zbatim efikas i projektit, monitorim dhe raportim sipas planit.	Shërbim për menaxhimin e projektit, koordinimin e aktiviteteve, monitorimin teknik dhe financiar, raportimin dhe administrimin e kontratës.	1,000,000.0	FSHZH	Shërbim	12	01/01/2027	01/01/2028
Projektimi teknik, studimet paraprake dhe dokumentacioni	Dokumentacion teknik dhe administrativ i përfunduar.	Shërbim për hartimin e projektit arkitektonik, projektin teknik, preventivin, specifikimeve teknike dhe dokumentacionit për zbatimin e investimit.	900,000.0	NJVV	Shërbim	2	01/01/2027	01/03/2027

Emërtimi i Aktivitetit	Përshkrim i shkurtër i Aktivitetit	Objekti i kontratës	Buxheti i Kontratës në Lekë:	Burimi i Financimit	Lloji i procedurës	Koha e parashikuar për realizimin e procedurës së prokurimit (në muaj):	Data e parashikuar e fillimit të kontratës	Data e parashikuar e përfundimit të kontratës
Rikonstrukcioni dhe përshtatja e "Vilës së Rilindjes"	Godinë moderne dhe funksionale sipas standardeve të turizmit.	Kontratë punimesh për rikonstrukcionin e godinës, punime ndërtimore, elektrike, hidraulike, termoizolim, fasadë, ambiente të brendshme dhe të jashtme.	11,500,000.0	FSHZH	Punime	6	01/02/2027	01/08/2027
Mobilimi dhe pajisja e ambienteve	Ambiente plotësisht të pajisura dhe funksionale.	Ambiente plotësisht të pajisura dhe funksionale.	5,500,000.0	FSHZH	Mallra/Pajisje	4	01/05/2027	01/09/2027
Zhvillimi i platformës së Inteligjencës Artificiale dhe sistemit shumëgjuhësh	Platformë AI funksionale për komunikim virtual me figurat e Rilindjes.	Platformë AI funksionale për komunikim virtual me figurat e Rilindjes.	3,700,000.0	FSHZH	Mallra/Pajisje	6	01/03/2027	01/09/2027

Emërtimi i Aktivitetit	Përshkrim i shkurtër i Aktivitetit	Objekti i kontratës	Buxheti i Kontratës në Lekë:	Burimi i Financimit	Lloji i procedurës	Koha e parashikuar për realizimin e procedurës së prokurimit (në muaj):	Data e parashikuar e fillimit të kontratës	Data e parashikuar e përfundimit të kontratës
Krijimi i përmbajtjes historike, dixhitalizimi dhe përkthimi shumëgjuhësh	Përmbajtje historike e verifikuar dhe e disponueshme në disa gjuhë.	Përmbajtje historike e verifikuar dhe e disponueshme në disa gjuhë.	1,200,000.0	FSHZH	Mallra/Pajisje	4	01/04/2027	01/08/2027
Pajisje teknologjike (serverë, kompjuterë, ekrane interaktive, projektorë, sisteme audio dhe rrjet interneti)	Blerja e pajisjeve teknologjike	Infrastrukturë teknologjike e instaluar dhe funksionale.	1,500,000.0	NJVV	Mallra/Pajisje	3	01/05/2027	01/08/2027
Marketingu, identiteti vizual dhe promovimi i projektit	Rritje e vizibilitetit dhe promovimi i destinacionit.	Rritje e vizibilitetit dhe promovimi i destinacionit.	700,000.0	FSHZH	Shërbim	4	01/09/2027	01/01/2028

Emërtimi i Aktivitetit	Përshkrim i shkurtër i Aktivitetit	Objekti i kontratës	Buxheti i Kontratës në Lekë:	Burimi i Financimit	Lloji i procedurës	Koha e parashikuar për realizimin e procedurës së prokurimit (në muaj):	Data e parashikuar e fillimit të kontratës	Data e parashikuar e përfundimit të kontratës
Organizimi i inaugurimit dhe aktiviteteve kulturore	Hapje zyrtare dhe prezantimi i projektit për publikun dhe operatorët turistikë.	Shërbim për organizimin e ceremonisë inaugurimit, aktiviteteve promovues, eventeve kulturore dhe mbulimit mediatik të projektit.	400,000.0	FSHZH	Shërbim	12	01/01/2027	01/01/2028

Përmbledhja e Buxhetit

Total Vlerë e FSHZH	Total Vlerë e bashkëfinancimit	Total Vlerë nga Donatorë të tjerë	Total Buxheti i projektit
24,000,000.00 L	2,400,000.00 L	0.00 L	26,400,000.00 L

6. NDIKIMI DHE QËNDRUESHMËRIA E PROJEKTIT

Përshkruani ndikimin që parashikohet të ketë projekti tek grupi i synuar/përfituesit e tij përfundimtarë dhe përdorni të dhëna sasiore kudo që është e mundur. Shpjegoni se si pritet që rezultatet/produktet kryesore të projektit të japin një kontribut të rëndësishëm dhe afatgjatë për zgjidhjen e sfidave të synuara.

Shpjegoni se si projekti do të jetë i qëndrueshëm pas përfundimit të tij:

a) Qëndrueshmëria financiare: p.sh., financimi i aktiviteteve vijuese më vonë, burimet e të ardhurave për të mbuluar të gjitha kostot e ardhshme operative dhe të mirëmbajtjes;

Qëndrueshmëria financiare e projektit "Vila e Rilindjes" do të sigurohet përmes një modeli biznesi të diversifikuar, i cili kombinon të ardhurat nga shërbimet turistike, aktivitetet kulturore dhe partneritetet me sektorin privat. Pas përfundimit të

financimit fillestar, projekti do të jetë në gjendje të mbulojë kostot operative dhe të mirëmbajtjes përmes të ardhurave të gjeneruara nga aktiviteti i tij.

Burimet kryesore të të ardhurave do të jenë:

Të ardhurat nga restoranti dhe shërbimet gastronomike me produkte tradicionale të zonës;

Të ardhurat nga akomodimi në "Vilën e Rilindjes";

Tarifat për përvojën interaktive me inteligjencën artificiale dhe interpretimin virtual të figurave të Rilindjes;

Organizimi i aktiviteteve kulturore, eventeve tematike, seminareve dhe vizitave edukative për shkolla, universitete dhe grupe turistike;

Bashkëpunimet me agjencitë turistike dhe operatorët e udhëtimeve për krijimin e paketave turistike të integruara.

Këto burime të ardhurash do të mundësojnë mbulimin e kostove të përditshme të funksionimit, duke përfshirë pagat e stafit, furnizimin me produkte ushqimore, shpenzimet për energjinë, internetin, sigurimet, marketingun, mirëmbajtjen e godinës dhe përditësimin periodik të platformës së inteligjencës artificiale.

Për të garantuar qëndrueshmërinë afatgjatë, një pjesë e të ardhurave do të riinvestohet çdo vit për mirëmbajtjen e pajisjeve teknologjike, përmirësimin e përmbajtjes dixhitale, zhvillimin e shërbimeve të reja dhe rritjen e cilësisë së përvojës së vizitorëve. Ky mekanizëm do të sigurojë që projekti të mbetet konkurrues dhe të përshtatet me zhvillimet teknologjike dhe kërkesat e tregut.

Në fazat e mëvonshme, projekti do të synojë të tërheqë financime shtesë për zgjerimin e aktivitetit përmes programeve kombëtare dhe ndërkombëtare, partneriteteve me institucione kulturore dhe universitete, si dhe bashkëpunimeve me sponsorë dhe kompani private të interesuara për promovimin e trashëgimisë kulturore dhe inovacionit.

Modeli financiar i projektit bazohet në një kombinim të të ardhurave të gjeneruara nga tregu dhe riinvestimit të vazhdueshëm të fitimeve, duke siguruar që aktivitetet e krijuara të vazhdojnë edhe pas përfundimit të investimit pa qenë të varura nga financime të tjera publike. Kjo e bën "Vilën e Rilindjes" një investim ekonomikisht të qëndrueshëm, me kapacitet për të mbuluar kostot operative, për të ruajtur cilësinë e shërbimeve dhe për të zhvilluar më tej ofertën turistike në afat të gjatë.

b) Qëndrueshmëria institucionale: p.sh., strukturat që do të mundësojnë që rezultatet e projektit të vazhdojnë të jenë funksionale edhe pas përfundimit të projektit, ngritja e kapaciteteve, marrëveshjet dhe "pronësia" vendore e rezultateve të projektit.

Qëndrueshmëria institucionale e projektit "Vila e Rilindjes" do të mbështetet në krijimin e një strukture të qartë menaxhimi dhe në bashkëpunimin afatgjatë me institucionet publike, komunitetin lokal dhe partnerët privatë. Pas përfundimit të financimit, funksionimi i projektit do të vazhdojë përmes një ekipi të dedikuar administrativ (drejtoria e Artit dhe Kulturës, drejtoria e Turizmit, Sektori i IT, Sektori i Marketingut) dhe operacional, i cili do të jetë përgjegjës për menaxhimin e aktivitetit, mirëmbajtjen e infrastrukturës, përditësimin e platformës së inteligjencës artificiale dhe koordinimin me partnerët. Projekti bazohet në një model me pronësi dhe përfshirje të fortë vendore. Përdorimi i produkteve lokale, angazhimi i burimeve njerëzore të zonës dhe bashkëpunimi me bizneset vendase do të krijojnë ndjenjën e pronësisë nga komuniteti, duke rritur motivimin për ta mbështetur dhe zhvilluar projektin edhe në të ardhmen. Përfshirja aktive e aktorëve lokalë do të sigurojë që rezultatet e projektit të mos përfundojnë me mbylljen e grantit, por të integrohen në zhvillimin afatgjatë të turizmit dhe ekonomisë lokale. Për më tepër, platforma teknologjike dhe përmbajtja e krijuar gjatë projektit do të administrohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme nga struktura menaxhuese, duke garantuar funksionalitetin, cilësinë dhe përshtatjen me zhvillimet e reja teknologjike dhe kërkesat e vizitorëve.

c) Qëndrueshmëria mjedisore (nëse ka): çfarë ndikimi do të ketë ky projekt në mjedis? Ky informacion duhet të paraqitet vetëm për ndërhyrje që mund të kenë ndikim në mjedis.

Po, projekti pritet të ketë një ndikim pozitiv në mjedis. Një nga elementët kryesorë është rikonstruksioni dhe ripërdorimi i një godine ekzistuese jofunksionale, duke shmangur nevojën për ndërtimin e një objekti të ri dhe duke reduktuar konsumin e burimeve natyrore dhe ndikimin mjedisor që lidhet me ndërtime të reja. Në tërësi, projekti nuk parashikon aktivitete që shkaktojnë ndotje të konsiderueshme të ajrit, ujit apo tokës.

Deklaratë e Aplikantit

Aplikanti, i përfaqësuar nga i nënshkruari, i cili është gjithashtu personi i autorizuar për të firmosur në emër të tij, në kuadër të kësaj thirrjeje për propozime deklaron sa vijon:

- Aplikanti është përgjegjës i drejtpërdrejtë për përgatitjen, administrimin dhe zbatimin e projektit.
- Aplikanti është në gjendje të dorëzojë, sipas kërkesës, dokumentet shoqëruese dhe mbështetëse të përcaktuara në fazën e dytë të udhëzuesit për aplikantët.
- Aplikanti garanton se ka kompetencën dhe autorizimin e nevojshëm për të lidhur në mënyrë të rregullt dhe të vlefshme Marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe Marrëveshjen e Investimit me FSHZH.
- Në rast për zgjedhje, aplikanti pranon kushtet kontraktuale të përcaktuara në Marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe Marrëveshjen e Investimit.
- Aplikanti merr përsipër të vërë në dispozicion burimet e tij organizative, njerëzore, teknike dhe logjistike për të siguruar zbatimin në kohë dhe në mënyrë efikase të projektit.
- Aplikanti garanton se ka kapacitete profesionale të mjaftueshme për zbatimin e aktiviteteve të projektit të propozuar.
- Aplikanti garanton ushtrimin e funksioneve dhe detyrave në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- Aplikanti garanton zbatimin e projektit në përputhje me standardet dhe parimet e kontrollit të brendshëm sipas legjislacionit shqiptar.
- Aplikanti ka kapacitet të mjaftueshëm financiar për bashkëfinancimin e projektit të propozuar.

Titullari i Institucionit

Firmë dhe Vullë